

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

NË MES

TË BANKËS SË SLLOVENISË

DHE

AUTORITETIT BANKAR DHE TË PAGESAVE TË KOSOVËS

**LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN E TYRE NË FUSHËN E MBIKQYRJES SË
BANKAVE**

TABELA E PËRMBAJTJES

Autoritetet kompetente

Definimet

Fshehtësia Profesionale

Shkëmbimi i informatave

Licencimi, kontrolli i pronësisë dhe menaxhmenti

Ekzaminimet në vend

Ligjet dhe rregulloret

Mbikqyrja e vazhdueshme dhe përmirësimet

Të ndryshme

Banka e Sllovenisë, (këtej e tutje BoS), e përfaqësuar nga Z. Mitja Gaspari, Guvernator, dhe Autoriteti Bankar dhe Pagesave të Kosovës (këtej e tutje BPK) e përfaqësuar nga Z. Michel Svetchine, Drejtor i Përgjithshëm, të dy këtej e tutje të referuar si “Autoritete”; duke përkujtuar Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të 10 qershor 1999, me anë të së cilës Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, e autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe me asistencë të organizatave relevante ndërkombëtare për një prezencë civile ndërkombëtare në Kosovë, themeloi Misionin e njohur të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me qëllim që të sigurohet një administratë e përkohshme në Kosovë sipas mandatit të përshkruar në rezolutë, ku njëherit është kompetente për karakterin e përkohshëm të BPK-së si pjesë e administrimit të përkohshëm në Kosovë; shprehën gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar mbi bazën e besimit dhe mirëkuptimit reciprok ku edhe u pajtuan që të bazojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e mbikqyrjes së bankave sipas parimeve dhe procedurave të theksuara në këtë memorandum.

Kornizë e Përgjithshme e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit janë Parimet Kryesore për Mbikqyrjen Efektive Bankare të nxjerrë nga Komiteti i Bazelit mbi Mbikqyrjen Bankare në shtator 1997 (këtej e tutje: Parimet Kryesore).

Bashkëpunimi i Autoriteteve sipas këtij Memorandumi do të kryhet në pajtim me parimet e reciprocitetit.

Qëllimi i këtij Memorandumi është krijimi i bashkëpunimit në mes të Autoriteteve për të ndihmuar efikasitetin e mbikqyrjes dhe siguruar mbikqyrjen e bankave në baza të konsoliduara.

Autoritetet Kompetente

1. BoS është përgjegjëse për mbikqyrjen bankare sipas Dekretit Bankar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, Nr 7/99, 59/01, 55/03 dhe 42/04), Dekret i Bankës së Sllovenisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, Nr 58/02, 85/02) dhe ligje të tjera të veçanta).

BPK-ja vepron si autoritet i mbikqyrjes bankare sipas Regullores së UNMIK-ut Nr.2001/24 të adaptuar më 1 tetor, 2001 dhe e plotësuar me Regulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave në Kosovë, dhe Regulloren e UNMIK-ut Nr.1999/21 mbi Licencimin, Mbikqyrjen dhe Regullimin Bankar.

Definimet

2. Për qëllimet e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, shprehjet me sa vijojnë do të kenë kuptimin me sa vijon:

Kompanitë Ndër-Kufitare:	“Filiala është një jurisdikcion që është i themeluar nga zyra kryesore e bankës që është e inkuorporuar dhe licencuar në jurisdikcionin tjetër, apo Ekspoziturë e inkuorporuar dhe e licencuar në një jurisdikcion që direkt apo indirekt është e kontrolluar nga banka amë që është e inkuorporuar dhe licencuar në jurisdiksione tjera.
Filiala:	“Njësi organizative e licencuar në një jurisdikcion të bankës që është e inkuorporuar dhe licencuar në një jurisdikcion tjetër.
Ekspozitura:	“Një bankë e inkuorporuar dhe licencuar në një jurisdikcion që direkt apo indirekt është e kontrolluar nga banka amë e inkuorporuar dhe licencuar në jurisdikcionin tjetër”.
Mbikqyrësi i Brendshëm:	“Autoriteti që mbikqyr bankën kryesore në rastin e Filialës, apo që mbikqyr bankën amë në rastin e Ekspoziturës”.
Mbikqyrësi i Jashtëm:	“Autoriteti që mbikqyr një Filialë apo Ekspoziturë brenda jurisdikcionit të tij”.

Fshehtësia Profesionale

3. Përputhja me obligimet e fshehtësisë profesionale nga të gjithë punëtorët dhe zyrtarët që marrin informata nga jurisdikcionet tjera relevante në kuadër të aktiviteteve të tyre është një kusht i domosdoshëm për bashkëpunim të suksesshëm në mes të Autoriteteve. Autoritetet do të sigurojnë përputhje të plotë me kriteret esenciale të Parimit Kryesor 1 (6).

BoS është subjekt i përmbushjes së kërkesave të fshehtësisë profesionale në shkallën e specifikuar të Kapitullit IV dhe VII të Dekretit Bankar.

BPK-ja është subjekt i përmbushjes së kërkesave të fshehtësisë profesionale në shkallën e specifikuar në Nenin 34 të Regullores së UNMIK-ut 2001/24.

Autoritetet nuk do të zbulojnë kurrëfarë informate konfidenciale te palët e treta pa pajtimin paraprak me shkrim të autoritetit që ka siguruar këtë informatë konfidenciale.

Nëse zbulimi i informatës konfidenciale në agjensionin qeveritar vendës (psh. Gjykata, Administrata Tatimore etj) kërkohet me ligjin e Sllovenisë apo ligjin e aplikueshëm në Kosovë, Autoritetet menjëherë do të njoftojnë njëri tjetrin.

Shkëmbimi i informatave

4. Autoritetet mbështesin parimin e gjerë të shkëmbimit të informatave me njëri tjetrin për të mbështetur dhe ndihmuar detyrat e tyre përkatëse të mbikqyrjes. Autoritetet theksojnë gatishmërinë për të ndarë informatën mbi aktivitetet lidhur me Kompanitë Ndër-Kufitare dhe bankat e tyre amë të rregulluara nga Mbikqyrja Bankare e Sllovenisë dhe Kosovës.

Në kuptim më të gjerë kjo do të thotë se do të ketë kontakte, me shkrim apo me gojë, kurdo që Mbikqyrësi i Brendshëm apo i Jashtëm e konsideron këtë të dobishme apo të nevojshme mbi baza të fakteve apo zhvillimeve relevante për qëllime mbikqyrëse të veta apo të njëri tjetrit. Mbikqyrësi i Jashtëm do të paralajmërojë Mbikqyrësin e Brendshëm menjëherë për çfarëdo aktiviteti lidhur me Filialën apo Ekspoziturën që mund të rrezikojë stabilitetin e bankave si tërësi. Ata do të informojnë njëri tjetrin lidhur me ndëshkimet administrative apo paditë tjera të caktuara për Filialën, Ekspoziturën apo Bankën si tërësi, ku siç janë ata të informuar ndëshkimi dhe paditë tjera mund të jenë të një rëndësie materiale.

Përveç kësaj, do të ketë komunikime në mes Autoriteteve lidhur me çfarëdo ndryshimi substancial në rregulloret dhe politikat përkatëse të mbikqyrjes vendore.

Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave do të bëhet nga personat e autorizuar nga të dy palët.

Licencimi, kontrolli i pronësisë dhe menaxhmenti

5. Nëse banka e inkuorporuar në një apo në dy jurisdiksione ka të bëjë me autoritetin e jurisdiksionit tjetër për të themeluar një Filialë apo Ekspoziturë, ky i fundit do të informojë Mbikqyrësin e Brendshëm pa vonesë. Nëse aftësitë e mbikqyrjes së brendshme (vendore) janë domosdoshmëri legjitime që Mbikqyrësi i Jashtëm duhet të adresojë në procedurën e licencimit, atij i duhet të kontaktojë autoritetin e jurisdiksionit vendor për të shtruar çfarëdo pyetje lidhur me këtë.

Mbikqyrësi i Brendshëm informon Mbikqyrësin e Jashtëm për shumën e fondeve vetanake dhe normën e solvencës së bankës amë, nëse banka amë është e autorizuar për të siguruar shërbimet bankare dhe shërbime të tjera financiare, nëse plotësisht i nënshtrohet dhe përputhet me rregulloren vendore bankare, dhe nëse pritet që në dritën e strukturës së saj administrative dhe kontrollit të brendshëm të drejtojnë kompanitë ndër-kufitare në mënyrë të rregullt dhe të duhur. Mbikqyrësi i Brendshëm zbulon çdo pjesë të informatës në dispozicion të Mbikqyrësi i Jashtëm që mund të rrit dyshimet në aftësinë dhe korrektësinë e menaxherëve perspektivë të Kompanive Ndër-Kufitare.

Autoritetet do të kërkojnë dëshmi të aprovimit paraprak (nëse dhënia e aprovimit të tillë është e specifikuar me rregulloret e Autoriteteve) para dhënies së autorizimit në Ekspoziturën e bankës së autorizuar në jurisdiksionin tjetër apo vlerësimin e çfarëdo blerjeje të aksioneve në bankën vendore përmes bankës së jurisdiksionit të Autoritetit tjetër.

Mbikqyrësi i Brendshëm do t'i sigurojë Mbikqyrësit të Jashtëm (me një kërkesë me shkrim dhe në një masë të arsyeshme) informatën lidhur me strukturën e aksionarit, përfshirë por jo të kufizuar në aksionarë me aksione të konsiderueshme në bankën amë /kryesore të Kompanisë Ndër-kufitare të inkuorporuar në jurisdiksonin e Mbikqyrësit të Jashtëm.

Mbikqyrësi i Jashtëm do t'i sigurojë Mbikqyrësit të Brendshëm (me një kërkesë me shkrim dhe në një masë të arsyeshme) informatën lidhur me strukturën e aksionarit, përfshirë por jo të kufizuar në aksionarë me aksione të konsiderueshme në Ekspoziturë të bankës amë të autorizuar në jurisdiksonin e Mbikqyrësit të Brendshëm.

Informata nga ky seksion do të përfshijë ndryshimet substanciale në strukturën e aksionarit në bankën përkatëse, duke theksuar se një entitet tjetër apo grup i entiteve përkatëse kanë marrë kontrollin e bankës.

Për qëllim të këtij seksioni asetet e konsiderueshme do të nënkuptojnë asete direkte apo indirekte me 10% apo më tepër të kapitalit, të drejta të votimit apo ushtrim të dukshëm të ndikimit të menaxhmenti i bankës ku gjenden aksionet.

Autoritetet mbikqyrëse të jurisdiksioneve përkatëse do të sigurojnë njeri tjetrin me informata (me një kërkesë meshkrim dhe deri në masën e arsyeshme) për individët apo ndërmarrjet që kanë apo kërkojnë kontrollin e një banke apo më shumë bankave të inkuorporuara në jurisdiksonin tjetër.

Ekzaminimet në vend

6. Duke njohur rëndësinë e mbikqyrjes së konsoliduar, Autoritetet pajtohen që bashkëpunimi i tyre të jetë veçanërisht i dobishëm në asistimin e njëri tjetrit në kryerjen e ekzaminimeve në vend të Kompanive Ndër-Kufitare.

Në rrjedhjen e përgatitjeve të planit të ekzaminimit, Mbikqyrësi i Jashtëm do të informojë Mbikqyrësin e Brendshëm rreth periudhës së caktuar për ekzaminimin në vend të Ekspoziturës apo Filialës.

Mbikqyrësi i Jashtëm do të lejojë Mbikqyrësin e Brendshëm për të kryer ekzaminimet e Filialave dhe Ekspoziturave në jurisdiksonin e jashtëm. Mbikqyrësi i Brendshëm do të lejojë ekzaminimin në vend, me njoftimin paraprak të institucionit që i nënshtrohet ekzaminimit, qëllimit të ekzaminimit, kohëzgjatjes së prituri dhe personat që e kryejnë atë.

Mbikqyrësi i Jashtëm ka të drejtë të ketë përfaqësuesit që e shoqërojnë në çfarëdo ekzaminimi të tillë në vend. Siç është dakorduar, Mbikqyrësi i Jashtëm do të informohet lidhur me rezultatet e një ekzaminimi të tillë në një shkallë të arsyeshme dhe me kohë.

Ligjet dhe regulloret

7. Autoritetet këshillojnë njeri tjetrin me anë të kërkesës lidhur me çfarëdo aspekti të sistemit të tyre rregulator dhe e njoftojnë njeri tjetrin për çfarëdo ndryshimi kryesor në rregullat dhe regulloret e tyre vendore, në veçanti për ato ndryshime që kanë ndikim të dukshëm në aktivitetet e Kompanive Ndër-Kufitare, në përforcimin e ligjeve dhe regulloreve që kanë të bëjnë me sektorin bankar, informatat rreth zhvillimeve të sektorit bankar në Slloveni dhe Kosovë. Kjo përfshin shkëmbimin e informatave dhe -nëse është e nevojshme-konsultimet në skemën e garancionit të depozitave.

Informatat do të shkëmbehen në mes të Autoriteteve me shkrim dhe me gojë, pa kërkesë apo me kërkesë, dhe po ashtu gjatë sesioneve të konsultimit në mes të autoriteteve të menaxhmentit dhe stafit tjetër të emëruar.

Mbikqyrja e vazhdueshme dhe përmirësimet

8. Autoritetet do të njoftojnë njeri tjetrin, në një kohë të duhur dhe masë të arsyeshme për çfarëdo ngjarje që ka potencial të rrezikojë stabilitetin e bankës me Kompanitë Ndër-Kufitare në jurisdiksonin tjetër përkatës. Në veçanti, kjo ka të bëjë me:

-krizë fillestare, çfarëdo shkelje serioze të ligjeve dhe regulloreve të punëve bankare praktike, zvoglim në mjaftueshmërinë e kapitalit deri nën limitin minimal të caktuar nga Autoritetet në baza vetanake dhe të konsoliduara, kryerje të biznesit në atë mënyrë që dobëson interesin e depositorëve të bankës apo kërcënon sigurinë dhe stabilitetin e sistemit bankar apo ndonjë informatë tjetër të natyrës serioze.

Ata po ashtu njoftojnë njeri tjetrin për ndëshkimet administrative që ata janë të ngarkuar apo ndonjë veprim tjetër që ata e kanë marrë lidhur me Kompanitë Ndër-Kufitare si Mbikqyrës i Jashtëm, nëse bazohen në gjykimet e tyre, informimi është i rëndësishëm sidomos për Autoritetet si:

- kufizimi dhe anulimi i disa aktiviteteve të përmendura në licencë

-kërkimi i ndryshimeve në Bordin e Menaxhmentit (trupi ekzekutiv) dhe Bordin Mbikqyrës (Bordi i Menaxhimit) të bankës

-krijimi i shumave të duhura të rezervave, dhe zërat e veçantë të shlyerjes së borxhit.

-ulja e kapitalit fillesatar të bankës;

-implementimi i administrimit të detyruar

-revokimi i licencës

-dhe masa të tjera mbikqyrëse të rëndësishme materiale

Njoftimi në mes të Autoriteteve do të jetë me shkrim, pa kërkesë dhe pa vonesë të tepruar. Autoritetet diskutojnë me njeri tjetrin për çfarëdo informate të rëndësishme mbi bankat që kanë Kompanitë Ndër-Kufitare në Slloveni dhe Kosovë. Përfaqësuesit e Autoriteteve mbajnë mbledhje të menjëhershme për të ndihmuar zgjidhjen e problemeve mbikqyrëse lidhur me Kompanitë Ndër-kufitare në Slloveni dhe Kosovë, kurdo që një palë e sheh si të nevojshme.

Të ndryshme

Asgjë në apo lidhur me këtë Memorandum nuk do të konsiderohet e injoruar, e shprehur apo e nënkuptuar, mbi privilegjet dhe përjashtimet e përcaktuara nga Kombet e Bashkuara, përfshirë UNMIK-un.

Palët do të bëjnë përpjekje të mëdha për të zgjidhur miqësisht çfarëdo mos pajtimi që vije nga ky Memorandum.

Ky Memorandum hyn në fuqi dhe bëhet i detyrueshëm me nënshkrimin e të dy palëve.

Ky Memorandum do të jetë në fuqi deri më 31 dhjetor 2005.

Afati i këtij Memorandumi automatikisht do të zgjatet për çdo vit kalendarik vijues derisa njëra palë të mos njoftojë mbi përfundimin e tij deri më 30 nëntor të çdo viti.

Të dy palët kontraktuese pajtohen se ky Memorandum do të ndryshohet apo plotësohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të dy palëve.

Pas nënshkrimit të këtij Memorandumi, brenda 10 ditësh, Autoritetet do të shkëmbejnë listat e personelit të autorizuar me detaje të plota kontakti. Lista e personelit të autorizuar do të freskohet në baza të rregullta apo mund të ndryshohet.

Pas nënshkrimit të Memorandumit, Autoritetet do të shkëmbejnë listat e bankave të licencuara në jurisdiksonet e tyre. Këto lista të bankave të licencuara do të frekohen në baza të rregullta apo mund të ndryshohen.

Autoritetet pajtohen se duhet të mbajnë mbledhje të rregullta për të diskutuar çështje të ndryshme lidhur me mbikqyrjen prudenciale të bankave të themeluara nga dy jurisdiksonet dhe mbi zhvillimet e sistemeve të tyre rregullatore dhe mbikqyrëse në baza vjetore.

E përgatitur në dy kopje në gjuhën angleze, ku të dy kopjet janë plotësisht autentike.

Nënshkruar në Ljubljane,
Më 11 mars, 2005

Për dhe në emër të Bankës së Sllovenisë

Mitja Gaspari
Guvernator

Për dhe në emër të Autoritetit Bankar dhe
të Pagesave të Kosovës

Michel Svetchine
Drejtore i Përgjithshëm